



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 4: Statistikat e Llogarive Kombëtare

Bruto Produkti Vendor TM2 2020



BRUTO PRODUKTI VENDOR TM2 2020

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), përkatësisht Departamenti i Llogarive Kombëtare (DLLK), publikon të dhënat e Bruto Produktit Vendor për tremujorin e dytë të vitit 2020, sipas aktiviteteve ekonomike dhe metodës së shpenzimeve me çmime aktuale dhe konstante.

Publikimi i BPV-së tremujore ka për qëllim që të japë një vlerësim koherent për ecurinë e ekonomisë.

Metodologjia për kalkulimin e BPV-së është sipas koncepteve dhe përkufizimeve të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010). Llogaritjet e BPV-së tremujore janë në konsistencë më ato vjetore.

BPV në tremujorin e dytë të vitit 2020 shënon ulje reale për -9.28 % krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak.

Aktivitetet ekonomike që shënuan rënie në këtë tremujor janë: ndërtimi -47.08%; tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimet ushqimore -24.4%; aktivitetet profesionale dhe administrative -16.39%; aktivitetet financiare dhe të sigurimit -6.71 %; bujqësia, pyjet dhe peshkimi -1.74%.

Aktivitetet ekonomike që kishin rritje në këtë tremujor janë: industria nxjerrëse, përpunuese, energjia elektrike, furnizimi me ujë 19.8%; informacioni dhe komunikacioni 29.6%; aktivitete të pasurive të paluajtshme 4.29%; arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të tjera shërbimi 4.64%; administrimi publik, arsimit dhe shëndetësia 4.73%.

Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve që kishin rënie janë: formimi i bruto kapitalit -41.09%; eksporti i shërbimeve -62.93%; dhe importi i mallrave dhe shërbimeve -19.77%.

Rritje në këtë tremujor kishte: eksporti i mallrave 12.18%; shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe JPSHESH 3.47%; dhe shpenzimet e konsumit final të qeverisë 8.58%.

Shënim: BPV tremujore sipas aktiviteteve ekonomike është paraqitur në nivelin A*10 të agregimit sipas klasifikimit NACE Rev.2

Për të dhëna më të detajuara, klikoni në platformën ASKdata: <http://askdata.rks-gov.net/>

Fatmir Morina-Drejtor i Departamentit të Llogarive Kombëtare

Ky publikim është përgatitur nga:

Xhevdie Fetahu-Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare

Nysret Sylejmani-Zyrtar i Llogarive Kombëtare

Ylli Shala-Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare

Ilir Mazrekaj-Zyrtar i Llogarive Qeveritare

Emine Bajrami-Zyrtare e Llogarive Kombëtare

Florije Krapa-Zyrtare e Llogarive Kombëtare

Besim Mehmeti-Zyrtar i Llogarive Kombëtare

Kaltrina Veselaj-Zyrtare e Llogarive Kombëtare

Prishtinë, Shtator 2020

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së
Isa Krasniqi

Tabela 1- Bruto Produkti Vendor Tremujor

(Milionë EUR)

| | 2019* | | | | 2020* | |
|--|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|---------------|
| | I | II | III | IV | I | II |
| BPV-ja Nominale | 1,421 | 1,824 | 1,967 | 1,877 | 1,438 | 1,636 |
| BPV-ja Reale | 1,404 | 1,790 | 1,952 | 1,860 | 1,440 | 1,655 |
| <i>Norma reale e rritjes së BPV-së %</i> | <i>4.24</i> | <i>4.13</i> | <i>4.38</i> | <i>3.94</i> | <i>1.31</i> | <i>(9.28)</i> |

Grafiku 1. Rritja reale e BPV-së tremujore krahasuar me periudhën përkatëse të vitit paraprak




Tabela 2.Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale.

(Mijëra EUR)

| Nace Rev.2 | | Tremujorët | | | | Tremujorët | |
|--------------------------------|---|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| | | 2019 | | | | 2020 | |
| | | I* | II* | III* | IV* | I* | II* |
| A | Bujqësia, pyjet dhe peshkimi | 95,477 | 145,108 | 106,495 | 142,214 | 93,588 | 144,028 |
| B,C,D dhe E | Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit | 243,768 | 328,730 | 349,784 | 324,733 | 251,538 | 381,201 |
| C | <i>Nga të cilat: Industria përpunuese</i> | 124,826 | 220,230 | 240,116 | 231,322 | 131,291 | 261,768 |
| F | Ndërtimtaria | 101,601 | 203,442 | 177,467 | 160,651 | 87,585 | 105,439 |
| G,H dhe I | Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor | 225,267 | 311,380 | 429,333 | 355,048 | 226,595 | 231,297 |
| J | Informacioni dhe komunikacioni | 24,740 | 25,491 | 38,904 | 40,148 | 25,291 | 33,099 |
| K | Aktivitetet financiare dhe të sigurimit | 63,209 | 70,463 | 72,768 | 61,896 | 64,438 | 55,970 |
| L | Aktivitete të pasurive të paluajtshme | 121,104 | 128,639 | 127,845 | 127,805 | 122,663 | 133,869 |
| M and N | Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse | 37,332 | 32,481 | 36,474 | 45,215 | 38,876 | 27,187 |
| O,P, and Q | Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimit; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale | 223,956 | 233,080 | 226,089 | 257,336 | 231,975 | 253,321 |
| R,S,T and U | Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera | 9,901 | 11,287 | 8,758 | 6,670 | 7,329 | 11,869 |
| Bruto vlera e shtuar | | 1,146,355 | 1,490,101 | 1,573,917 | 1,521,716 | 1,149,879 | 1,377,281 |
| <i>Taksat neto në produkte</i> | | 274,959 | 333,863 | 393,497 | 355,170 | 288,267 | 258,441 |
| Bruto Produkti Vendor | | 1,421,314 | 1,823,963 | 1,967,415 | 1,876,887 | 1,438,146 | 1,635,721 |

*E vlerësuar

Tabela 3. Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime të vitit paraprak.

(Mijëra EUR)

| Nace Rev.2 | | Tremujorët | | | | Tremujorët | |
|----------------------------------|---|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| | | 2019 | | | | 2020 | |
| | | I* | II* | III* | IV* | I* | II* |
| A | Bujqësia, pyjet dhe peshkimi | 91,426 | 136,429 | 106,388 | 144,194 | 95,334 | 142,586 |
| B, C, D dhe E | Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit | 240,639 | 330,761 | 348,292 | 323,115 | 253,808 | 393,807 |
| C | <i>Nga të cilat: Industria përpunuese</i> | 123,194 | 220,655 | 235,261 | 227,156 | 132,804 | 266,361 |
| F | Ndërtimtaria | 100,284 | 195,716 | 173,482 | 147,976 | 89,000 | 107,666 |
| G, H dhe I | Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor | 223,226 | 305,980 | 414,067 | 344,462 | 226,135 | 235,394 |
| J | Informacioni dhe komunikacioni | 24,272 | 24,962 | 38,159 | 39,293 | 25,103 | 33,035 |
| K | Aktivitetet financiare dhe të sigurimit | 60,799 | 70,057 | 72,311 | 63,625 | 66,823 | 65,734 |
| L | Aktivitete të pasurive të paluajtshme | 121,520 | 130,287 | 127,845 | 127,779 | 122,524 | 134,158 |
| M dhe N | Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse | 37,652 | 32,525 | 36,625 | 45,533 | 38,900 | 27,157 |
| O, P, dhe Q | Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimit; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale | 212,344 | 227,497 | 221,770 | 251,618 | 223,743 | 244,115 |
| R, S, T dhe U | Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera | 9,759 | 11,192 | 8,607 | 6,564 | 7,244 | 11,810 |
| Bruto vlera e shtuar | | 1,121,921 | 1,465,406 | 1,547,546 | 1,494,159 | 1,148,614 | 1,395,462 |
| Taksat neto në produkte | | 282,501 | 324,884 | 404,098 | 366,176 | 291,283 | 259,240 |
| Bruto Produkti Vendor | | 1,404,421 | 1,790,290 | 1,951,644 | 1,860,334 | 1,439,897 | 1,654,701 |
| Rritja reale e BPV-së (%) | | 4.24 | 4.13 | 4.38 | 3.94 | 1.31 | (9.28) |

*E vlerësuar

Tabela 4.Rritja reale e BPV-së (krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak)

(%)

| Nace Rev.2 | | Tremujorët | | | | Tremujorët | |
|--------------------------------|---|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|---------------|
| | | 2019 | | | | 2020 | |
| | | I* | II* | III* | IV* | I* | II* |
| A | Bujqësia, pyjet dhe peshkimi | (0.23) | (0.31) | (2.87) | 0.14 | (0.15) | (1.74) |
| B,C,D dhe E | Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar; furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit | (2.10) | 6.67 | 7.90 | 4.68 | 4.12 | 19.80 |
| C | <i>Nga të cilat: Industria përpunuese</i> | 2.01 | 10.60 | 6.86 | 2.73 | 6.39 | 20.95 |
| F | Ndërtimtaria | 12.86 | 6.85 | 3.46 | 1.87 | (12.40) | (47.08) |
| G,H dhe I | Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor | 2.45 | 6.53 | 5.13 | 4.19 | 0.39 | (24.40) |
| J | Informacioni dhe komunikacioni | 2.99 | 2.18 | (0.95) | 1.95 | 1.47 | 29.60 |
| K | Aktivitetet financiare dhe të sigurimit | 10.14 | 22.39 | 11.78 | 4.85 | 5.72 | (6.71) |
| L | Aktivitete të pasurive të paluajtshme | 0.22 | 3.62 | 0.98 | 0.99 | 1.17 | 4.29 |
| M dhe N | Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse | 1.39 | 8.95 | 7.03 | 3.94 | 4.20 | (16.39) |
| O,P,dhe Q | Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale | 0.47 | (1.12) | 1.02 | 4.50 | (0.10) | 4.73 |
| R,S,T dhe U | Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera | 1.68 | 8.76 | (18.72) | (35.76) | (26.84) | 4.64 |
| Bruto vlera e shtuar | | 1.78 | 5.05 | 4.00 | 3.11 | 0.20 | (6.35) |
| <i>Taksat neto në produkte</i> | | 15.28 | 0.18 | 5.87 | 7.49 | 5.94 | (22.35) |
| Bruto Produkti Vendor | | 4.24 | 4.13 | 4.38 | 3.94 | 1.31 | (9.28) |

*E vlerësuar

Tabela 5.BPV tremujore sipas metodës së shpenzimeve me çmime aktuale

(Mijëra EUR)

| Komponentet e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve | Tremujorët | | | | Tremujorët | |
|---|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| | 2019 | | | | 2020 | |
| | I* | II* | III* | IV* | I* | II* |
| Shpenzimet e konsumit final | 1,482,072 | 1,774,654 | 1,613,571 | 1,998,954 | 1,542,050 | 1,819,951 |
| Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH | 1,253,594 | 1,533,111 | 1,378,214 | 1,702,369 | 1,307,558 | 1,548,691 |
| Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë | 228,478 | 241,543 | 235,357 | 296,585 | 234,492 | 271,261 |
| Formimi i bruto kapitalit | 362,731 | 634,402 | 571,725 | 565,682 | 335,039 | 366,141 |
| Exporti neto | (423,489) | (585,092) | (217,882) | (687,749) | (438,943) | (550,371) |
| Exporti i mallrave dhe shërbimeve | 360,270 | 408,837 | 939,883 | 359,359 | 379,670 | 229,494 |
| Exporti i mallrave | 78,478 | 104,053 | 114,681 | 96,006 | 98,133 | 114,929 |
| Exporti i shërbimeve | 281,792 | 304,784 | 825,202 | 263,353 | 281,537 | 114,565 |
| Importi i mallrave dhe shërbimeve | 783,759 | 993,928 | 1,157,764 | 1,047,108 | 818,613 | 779,865 |
| Importi i mallrave | 657,216 | 826,984 | 874,540 | 874,718 | 678,616 | 673,027 |
| Importi i shërbimeve | 126,544 | 166,944 | 283,224 | 172,390 | 139,997 | 106,838 |
| Bruto Produkti Vendor | 1,421,314 | 1,823,963 | 1,967,415 | 1,876,887 | 1,438,146 | 1,635,721 |

*E vlerësuar

Tabela 6.BPV tremujore sipas metodës së shpenzimeve me çmime të vitit paraprak

(Mijëra EUR)

| Komponentet e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve | Tremujorët | | | | Tremujorët | |
|---|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| | 2019 | | | | 2020 | |
| | I* | II* | III* | IV* | I* | II* |
| Shpenzimet e konsumit final | 1,524,793 | 1,745,785 | 1,588,002 | 1,997,293 | 1,544,845 | 1,848,646 |
| Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH | 1,308,505 | 1,510,428 | 1,353,624 | 1,706,468 | 1,318,733 | 1,586,382 |
| Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë | 216,288 | 235,357 | 234,378 | 290,825 | 226,112 | 262,264 |
| Formimi i bruto kapitalit | 372,422 | 625,665 | 565,428 | 531,132 | 341,520 | 373,754 |
| Exporti neto | (492,794) | (581,160) | (201,785) | (668,090) | (446,468) | (567,699) |
| Exporti i mallrave dhe shërbimeve | 288,330 | 386,186 | 928,686 | 361,505 | 378,158 | 229,711 |
| Exporti i mallrave | 78,147 | 103,171 | 113,129 | 95,273 | 98,470 | 116,724 |
| Exporti i shërbimeve | 210,184 | 283,015 | 815,557 | 266,231 | 279,688 | 112,987 |
| Importi i mallrave dhe shërbimeve | 781,125 | 967,347 | 1,130,471 | 1,029,595 | 824,625 | 797,410 |
| Importi i mallrave | 645,406 | 801,425 | 855,623 | 858,705 | 685,663 | 691,259 |
| Importi i shërbimeve | 135,719 | 165,922 | 274,848 | 170,890 | 138,962 | 106,151 |
| Bruto Produkti Vendor | 1,404,421 | 1,790,290 | 1,951,644 | 1,860,334 | 1,439,897 | 1,654,701 |

*E vlerësuar

Tabela 7. Rritja reale e BPV-së (krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak)

(%)

| Komponentet e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve | Tremujorët | | | | Tremujorët | |
|---|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|---------------|
| | 2019 | | | | 2020 | |
| | I* | II* | III* | IV* | I* | II* |
| Shpenzimet e konsumit final | 2.90 | (0.38) | 3.53 | 3.18 | 4.24 | 4.17 |
| Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH | 3.29 | 0.08 | 2.40 | 2.61 | 5.20 | 3.47 |
| Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë | 0.56 | (3.25) | 10.54 | 6.64 | (1.04) | 8.58 |
| Formimi i bruto kapitalit | 13.70 | 4.13 | 3.52 | 4.59 | (5.85) | (41.09) |
| Exporti i mallrave dhe shërbimeve | 6.64 | 14.35 | 9.33 | 12.88 | 4.97 | (43.81) |
| Exporti i mallrave | 3.63 | 5.89 | 14.67 | (8.69) | 25.47 | 12.18 |
| Exporti i shërbimeve | 7.80 | 17.78 | 8.63 | 23.31 | (0.75) | (62.93) |
| Importi i mallrave dhe shërbimeve | 6.64 | (0.45) | 6.67 | 5.70 | 5.21 | (19.77) |
| Importi i mallrave | 5.63 | (2.87) | 0.84 | 4.45 | 4.33 | (16.41) |
| Importi i shërbimeve | 11.75 | 13.18 | 30.09 | 12.42 | 9.81 | (36.42) |
| Rritja reale e Bruto Produkti Vendor | 4.24 | 4.13 | 4.38 | 3.94 | 1.31 | (9.28) |

*E vlerësuar

Shënime metodologjike

1. Mbulueshmëria

Përlllogaritjet përfshijnë të gjitha aktivitetet në bazë të koncepteve të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010).

2. Burimet e të dhënave

Vlerësimi i Llogarive Kombëtare Tremujore bazohet në burimet e disponueshme të të dhënave të LLK vjetore. Burimet kryesore të të dhënave përfshijnë: burime statistikore dhe burime administrative.

Burimet e të dhënave statistikore

- Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP);
- Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit (IHÇK);
- Indeksi i çmimeve të importit (IÇIMP);
- Indeksi i çmimeve të inputeve bujqësore;
- Indeksi i çmimeve të prodhimit bujqësor;
- Të dhënat e tregtisë së jashtme: importi dhe eksporti i mallrave;
- Statistikat e hotelarisë (numri i vizitorëve dhe numri i netëve);
- Statistikat e energjisë;
- Anketa e Fuqisë Punëtore;

Burimet e të dhënave administrative

Burimet e të dhënave administrative të përdorura për vlerësimin e BPV-së tremujore janë:

- Të dhënat mujore të njësive jo-financiare të marra nga Administrata Tatimore e Kosovës (të dhënat mujore lidhur me qarkullimin, pagat, kontributet për sigurime shoqërore, numri i të punësuarve, blerjet dhe shpenzimet);
- Të hyrat dhe shpenzimet e qeverisë në baza mujore;
- Pasqyrat financiare të Bankës Qendrore, bankave komerciale dhe kompanive të sigurimit;
- Të dhënat në baza mujore për bilancin e pagesave nga Banka Qendrore e Kosovës etj.

3. Metoda e vlerësimit

Llogaritë kombëtare tremujore janë në konsistencë me ato vjetore dhe janë të bazuara në të njëjtat koncepte, parime dhe strukturë.

4. Paraqitja e të dhënave

Të dhënat kryesore dhe kategoritë e paraqitura janë sipas koncepteve dhe terminologjisë së harmonizuar të ESA 2010. Të dhënat sipas aktiviteteve janë paraqitur sipas Klasifikimit statistikor të Aktiviteteve Ekonomike të Bashkësisë Evropiane (NACE Rev.2). Të dhënat në baza tremujore janë paraqitur në tabelat në vijim me çmime aktuale dhe si matje e vëllimit me çmime të vitit paraprak.

5. Përkufizime

Bruto Produkti Vendor - Treguesi më i rëndësishëm ekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare është Bruto Produkti Vendor (BPV), i cili paraqet performancën e ekonomisë së një shteti në një periudhë të caktuar kohore. Bruto Produkti Vendor me qasjen e prodhimit është i barabartë me vlerën e shtuar sipas aktiviteteve me çmime bazë, e rritur me tatimet mbi produkte, dhe të zvogëluar për vlerën e subvencioneve në produkte. Në këtë mënyrë Bruto Produkti Vendor është i barabartë me shumën e vlerës së shtuar me çmime bazë të të gjitha njësive të prodhimit të një vendi (rezidentë) dhe tatimeve neto në produkte (tatimet minus subvencionet mbi produkte).

BPV=BVSH+TP-SP

BPV = Bruto produkti vendor (me çmimet e tregut)

BVSH = Bruto vlera e shtuar (me çmimet bazë)

TP = Tatimet ne produkte

SP = Subvencionet në produkte

Konsumi i ndërmjetëm është vlera e përgjithshme e mjeteve të përdorura, konsumuara apo të transformuar gjatë procesit të prodhimit.

Vlera e shtuar bruto me çmime bazë është e barabartë me Outputin me çmimet bazë, të zvogëluar për konsumin e ndërmjetëm me çmime blerëse.

Çmim bazë Shuma që prodhuesi merr nga blerësi për njësi të produktit apo shërbimit të prodhuar, pa tatimet dhe subvencionet mbi produktin. Çmimi bazë përjashton shpenzimet e transportit të faturuara më vete.

Çmim tregu Është çmimi bazë pasi shtohen taksat mbi produktet minus subvencionet mbi produktet.

Çmime aktuale Çmimet e periudhës referuese. Ato përfaqësojnë çmimin e paguar për të mirat dhe shërbimet në kohën e prodhimit ose të konsumit.

Çmime konstante Çmime konstante janë në vlerë reale pra të korrigjuara për ndryshimet në çmime në lidhje me një vit bazë. Ato janë një mënyrë për të matur ndryshimin real në prodhim.

Konsumi final i ekonomive shtëpiake

Ky transaksion është regjistruar sipas çmimeve blerëse dhe përbëhet nga shpenzimet e ekonomisë familjare për të gjitha mallrat dhe shërbimet, me përjashtim të shpenzimeve për banim, të cilat konsiderohen si formim i bruto kapitalit fiks të pronarit. (Megjithatë, qiratë e objekteve dhe banesave klasifikohen si konsum final i shpenzuar nga ekonomia familjare).

Konsumi final nga institucionet qeveritare dhe Jo-fitimprurëse

Shpenzimet e bëra nga dy sektorët e fundit mund të ndahen në dy kategori: individuale dhe kolektive. E para përbën shpenzimet e bëra për përfitime individuale, p.sh. shërbimet mjekësore. Shpenzimet kolektive kanë karakter publik, për shembull shpenzimet qeveritare në mbrojtjen dhe sigurinë publike do të përfshiheshin në këtë kategori.

Formimi i bruto kapitalit

Kjo tërësi paraqitet në llogaritë kapitale të llogarive kombëtare dhe në raportin mbi veprimtarinë qeveritare. Është njëra nga dy transaksionet kryesore në pasurit kapitale.

Siç nënkuptohet nga emri, në formimin e bruto kapitalit fiks paraqiten të gjitha marrjet dhe posedimi i pasurive fikse, që do të thotë se të gjitha pasurit e prodhuara, janë të natyrës jo financiare dhe janë transferuese ndërmjet njësive prodhuese. Pasurit kapitale mund të jenë të prekshme – p.sh. ndërtesat, objektet, makineria – ose jo të prekshme – p.sh. softuerët kompjuterik. Ngjashëm me konsumin, ky transaksion vlerësohet sipas çmimeve blerëse.

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: *Departamentet prodhuese; Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale. Departamentet mbështetëse; Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. Në kuadër të Agjencionit vepron edhe; Zyrat Rajonale;* Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 41, Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruarë terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** infoask@rks-gov.net
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>